

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	PRISHTINA 
---	--	--

Datë/a:	22.07.2021
Për/ Za/ To:	I.T.K. shpk
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës 

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 21.07.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “I.T.K. SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Implementimi i planit të mobiliteteit**”, me Nr. të Prok: **616 21 113 215** nxjerr:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË**, si e pa afatëshme ankesa e OE ankues “I.T.K. SH.P.K.”, e datës: 21.07.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Implementimi i planit të mobiliteteit**” me nr. të prokurimit: **616 21 113 215**, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.
- II. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: T.K. SH.P.K. ka bërë kërkesë për ri-shqyrtim me datë 21.07.2021

Autoriteti Kontraktues me datë 01.07. 2021 ka publikuar Njoftimin për kontrare. Afati i fundit për dorëzim të kërkesave për pjesmarrje është 22.07.2021

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve , par 3. i cili thekson:

“3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Operatori Ekonomik ankimor ka dorëzuar Kërkesen për rishqyrtim me date 21.07.2021.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.1. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që **ka parashtruar ankesë një dite para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.**

AK hedh poshte ankesen e parashtrua ne perrputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nen percakton se:

Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni;

ZPP, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimi te këtij vendimi.

